



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 789/6 Prot.

Tiranë, më 30.12. 2015

V E N D I M
Nr. 136, datë 30.12. 2015

**Mbi përfundimin e procedimit administrativ,
filluar me Urdhrin e verifikimit Nr.789/1 prot, datë 12.11.2015**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit Nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, neneve 80-104 të ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999, "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe Rregullores "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbiqëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në Bashkinë Pukë, për rastin e nëpunësit ***** ,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit të verifikimit Nr.789/1 prot, të datës 12.11.2015, pasi shqyrtova informacionin e përcjellë nëpërmjet kërkesës Nr. 789 prot, datë 11.11.2015 paraqitur nga kërkuesi ***** , vendosa nisjen e verifikimit në lidhje me ligjshmërinë e Vendimit të Komisionit Disiplinor, Nr.1 datë 06.10.2015 "*Largim nga shërbimi civil*", si Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore, Arsimit, Kulturës dhe Zhvillimit të Turizmit, pranë Bashkisë Pukë.

Nga aktet e administruara rezulton se, punonjësi ***** ka filluar punë, me Urdhrin nr. 24 në datë. 20.02.2012, me akt emërimi, në pozicionin "*Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore, Arsimit, Kulturës, Sporteve dhe Mardhënieve me Publikun dhe Informimin*". Në Bashkinë Pukë nga dokumentacioni i ndodhur në njësinë e burimeve njerëzore, konstatohet se disa dokumente në mënyrë indirekte tregojnë që marrëdhënia e punës në fjalë, ka filluar pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, sipas kërkesave të ligjit të kohës, nr. 8549 dt. 11.11.1999 "*Statusi i nëpunësit civil*".

Në përfundim të periudhës së provës, me Vendimin nr. 1 datë 01.03.2013, të Kryetarit të Bashkisë Pukë, punonjësi ***** është konfirmuar si nëpunës civil .

Nga aktet e vëna në dispozicion prej institucionit, me shkresën nr. 1089 prot, datë 27.11.2015, "Për vënie në dispozicion dokumentacioni", rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, me vendimin penal nr. 32, date 14.05.2008, ka vendosur:

*Deklarimin fajtor të të pandehurit Sokol Gjoni për kryerjen e veprës penale "Falsifikimit të dokumentave shkollorë" të kryer në bashkëpunim dhe në bazë të nenit 187/1 e 25 të Kodit Penal dënimin e tij për kryerjen e kësaj veprë me 150.000 lekë gjobë. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale i pandehuri ***** dënohet përfundimisht me 100.000 lekë gjobë.*

*Heqjen e të drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin ***** për një perjudhë 1 (një) vjeçare.*

Kundër këtij Vendimi është bërë ankim dhe Gjykata e Apelit Shkodër, me Vendimin nr. 320 datë 02.12.2008 ka vendosur : "Lënien në fuqi të Vendimit penal nr.32 datë 14.05.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë".

Nisur nga ky fakt, konstatoj se ndodhemi përpara një rasti, që drejtuesi i Bashkisë Puke në atë kohë, duke emëruar ***** me Urdhrin nr. 24, datë 20.02.2012, në detyrën e "Përgjegjësit të Sektorit të Burimeve Njerëzore, Arsimit, Kulturës, Sporteve dhe Mardhënieve me Publikun dhe Informimin", ka shkelur në mënyrë flagrante ligjin e kohës nr. 8549 dt. 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil". Kjo për faktin se në nenin 12 pika "d", të këtij ligji, në nëntitullin "Kërkesat të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil", parashikohet shprehimisht se për tu pranuar në shërbimin civil, kandidatët duhet: "Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një krimi".

Në lidhje me këtë çështje, qëndrimi i ligjvënësit është i vendosur, pasi edhe në dispozitën respektive, të nenit 21 pika "d", të ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, me një shtesë e cila ndalon pranimin në shërbimin civil edhe nëse konkurrenti është dënuar për kundravajtje penale të kryer me dashje .

Më tej, rezulton se ka vijuar paligjshmëria, kur drejtuesi i institucionit të Bashkisë Pukë, me Vendimin nr. 1, datë 01.03.2013, pasi ka organizuar dhe kryer edhe procedurën e konkurrimit ka vendosur, "Konfirmimin si Nëpunës Civil" të punonjësit ***** .

Nga verifikimi i dosjes personale të punonjësit ***** , rezulton se, nuk administrohej vërtetimi i gjëndjes gjyqësore (Dëshmi Penaliteti), me anë të së cilës ai duhej të vërtetonte, nëse kishte pasur, apo kishte probleme me organet e drejtësisë, ashtu siç kërkonte ligji nr. 8549 dt. 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil" (neni 12/d), i cili ish efektiv në atë kohë. Pra, ky punonjës, duke shfrytëzuar dhe neglizhencën në kryerjen e detyrës të njësisë së burimeve njerëzore dhe të eprorit direkt, ka shtrembëruar me dashje realitetin, duke u paraqitur si i padënuar e në këtë mënyrë është pranuar në shërbimin civil, pas kryerjes së procedurës së konkurrimit.

Shkelja e lejuar në momentin e pranimin në shërbimin civil të këtij punonjësi, është një shkelje flagrante e një dispozitë ndaluese të ligjit organik të kohës, që rregullonte shërbimin civil, gjë e cila bën absolutisht të pavlefshëm krejt procesin e rekrutimit.

Kjo është një situatë vazhduese edhe sot, pasi në bazë neneve 481 e vijues, të K.Pr. Penale është përcaktuar se, regjistrohen në regjistrin e gjendjes gjyqësore gjithë vendimet me të marrë formë të prerë, si edhe vendimet për dënimet plotësuese dhe fshirja e këtyre shënimeve bëhet vetëm në kushtet e përcaktuara në nenin 483 të K.Pr. Penale, që janë vdekja ose plotësimi i moshës 80 vjeç të të dënuarit; vendimet e revokuara për shkak të rishikimit apo shfuqizimit të veprës penale; dhënia e pafajësisë ose pushimi i çështjes, kur kanë kaluar 10 vjet nga dita kur vendimi ka marrë formë të prerë dhe vetëm për vendimet e dënimit për kundravajtje me gjobë kur nga dita e ekzekutimit të vendimit kanë kaluar 10 vjet.

Në rastin konkret, nuk ekziston asnjë nga kushtet e nenit 483 të K. Pr. Penale, gjë e cila do të thotë se shtetasi ***** , efektivisht, sot vazhdon të figurojë person i dënuar penalisht në regjistrat e gjendjes gjyqësore.

Nëse, punonjësi ***** , do të respektonte ligjin dhe në momentin e konkurrimit, do t'i duhej të paraqiste Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore, ku do të rezultonte i dënuar, gjë e cila do të përbënte rrethanë penguese për pranimin e tij në shërbimin civil. Në këto kushte nuk do të ishte lidhur marrëdhënia e punës me institucionin.

Nisur nga sa më sipër, arrij në përfundimin se Urdhri Nr. 24, në dt. 20.02.2012, i Kryetarit të Bashkisë Pukë, *“Për emërimin në punë të kandidatit fitues në pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore, Arsimit, Kulturës, Sporteve dhe Mardhënieve me Publikun dhe Informimin”*, për rrjedhojë edhe Vendimi nr. 1 datë 01.03.2013, për konfirmimin e punonjësit Sokol Gjoni si nëpunës civil, janë akte të nxjerra në kundërshtim flagrant me dispozitën e nenit 12/d të ligjit nr. 8549 dt. 11.11.1999 *“Statusi i nëpunësit civil”*, prandaj në bazë të neneve 115/a, 116/c dhe 117/1 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 *“Kodi i Procedurave Administrative në R.SH”* janë akte absolutisht të pavlefshme dhe si të tilla nuk mund të krijojnë një marrëdhënie punësimi në shërbimin civil.

Në këto kushte, marrëdhënia e punës së punonjësit në fjalë, nuk mund të jetë një marrëdhënie që rregullohet dhe mbrohet nga legjislacioni i shërbimit civil dhe në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në bazë të nenit 63/c dhe 65/“ç”, të këtij ligji, marrëdhënia e punësimit të punonjësit ***** me Bashkinë Pukë, duhej të kishte përfunduar, për shkak të konstatimit të pavlefshmërisë absolute, të aktit të emërimit në shërbimin civil dhe konfirmimit në fund të periudhës së provës, pasi edhe në nenin 21/d të ligjit në fjalë, mbahet qëndrim i njëjtë, madje më i rreptë: *“nuk mund të pranohet në shërbimin civil një person i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje”*.

Në analizë të gjithë sa janë thënë më sipër, arrij në përfundimin tjetër, se trajtimi i punonjësit ***** si nëpunës civil është një veprim i pambështetur në ligj dhe në këto kushte, kryerja e veprimeve të ndryshme procedurale, që sigurojnë mbrojtjen e një nëpunësi civil, janë efektivisht të panevojshme. Është fjala këtu, për gjithë aktet që kanë dalë për konstatimin e shkeljeve të ndryshme të disiplinës dhe marrjen e disa masave të lehta disiplinore, fillimin e ecursë disiplinore, kalimin e çështjes për trajtim në komisionin e disiplinës, ngritja e këtij komisioni dhe marrja e masës disiplinore.

Përfundimisht, çmoj se në këtë rast, për të rregulluar ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera, duhet të revokohet Urdhri Nr. 24 datë 20.02.2012, i Kryetarit të Bashkisë Pukë, për

emërimin e ***** , në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore, Arsimit, Kulturës, Sporteve dhe Mardhënieve me Publikun dhe Informimin” ashtu edhe Vendimi Nr. 1 datë 01.03.2013 i Kryetarit të Bashkisë Pukë, “Për konfirmimin si nëpunës civil”, si akte të dala në kundërshtim me ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe duhet të vendoset përfundimi i marrëdhënies së punësimit për shkak të konstatimit të pavlefshmërisë të aktit të emërimit (neni 65 pika “ç” e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar).

Po kështu, në këtë rast, duhet që njësia e burimeve njerëzore e institucionit, të na informojë nëse ka raste të tjera, të kësaj natyre, të trajtuara në të njëjtën mënyrë në Bashkinë Pukë.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14, 15, 21/d, 63/c, 65/ç, 66/ë dhe 66, pika 4/a, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; nenet 115, pika “a” dhe 117, pika 1, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative në R.SH”; nenin 35 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse që të realizojë procesin e revokimit të Urdhrit Nr. 24, datë 20.02.2012, të Kryetarit të Bashkisë Pukë, për emërimin punonjësit ***** , në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore, Arsimit, Kulturës, Sporteve dhe Mardhënieve me Publikun dhe Informimin”, si edhe të Vendimit Nr. 1, datë 01.03.2013, të Kryetarit të Bashkisë Pukë, “Për konfirmimin e tij si nëpunës civil”, si akte të dala në kundërshtim me ligjin nr. 8549 dt. 11.11.1999 “Statusi i nëpunësi civil” që ishte në fuqi në kohën e daljes së këtyre akteve dhe në bazë të nenit 65 pika “ç”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të vendoset përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.
2. Bashkia Pukë, të zbatojë Vendimin brënda 15 ditëve nga data e marrjes dijeni.
3. Të njoftohen për këtë vendim, Bashkia Pukë si dhe kërkuesi, ***** .
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA